



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 132, datë 30.09.2025

**PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË “RSM ALBANIA” SH.P.K., SI SHOQËRI AUDITUESE
PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE
“ALBSIG INVEST” SH.A., FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE FONDIT TË
INVESTIMIT NËN ADMINISTRIM, PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET NË
DATË 31.12.2025**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 33 dhe 107, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, nenit 35, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të SHAFP dhe SIK”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë “RSM Albania” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “Albsig Invest” sh.a., fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur “Albsig” dhe “Smart Pension” dhe fondit të investimit “Albsig Standard”, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2025.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**